



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 04 prot.

Kamëz, më 23.01. 2023

V E N D I M

Nr 04 Datë 23.01 / 2023

**"MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE GJATË VITIT 2023 PËR FAMILJET QË NUK JANË PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT, QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE"**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.01.2023, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.04 Datë 19.01.2023 në mbështetje të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligji nr.57 dt. 18/07/2019 "Për Asitencën Sociale në Republikën e Shqipërisë neni 21, VKM nr.597 dt. 04/09/2019 kreu 4 pika 3 për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike, Vendimin nr.617 datw 22.09.2022 për disa ndryshime në Vendimin 597/2019; Këshilli Bashkiak Kamëz";

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike", si më poshtë vijon:
2. Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh, por që jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme në banesa të papërshtatshme, (baraka, objekte të modifikuara për banim si ish-stallat, magazinat etj.), gra me problem dhune në familje.
3. Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh, por që janë të varfëra dhe kanë të gjithë fëmijët nxënës dhe student, nuk kanë anëtarë madhorë të tjerë për punë, përveç dy bashkëshortëve dhe që janë pa punë, të moshuar që janë të vetmuar dhe pa kujdestari.
4. Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh dhe k/familjar është gruaja e ve që merr një pension minimal për jetesë, ose e ndarë nga bashkëshorti (në proces) dhe nuk marrin pikët e mjaftueshme për tu kualifikuar si fitues të ndihmës ekonomike.
5. Familjet me pak anëtarë, por që refuzohen nga sistemi i pikëzimit, të cilat janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe të ardhura të pamjaftueshme, familje me kryefamiljarë në burg dhe fëmijë të vegjël.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

6. Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit, të cilat disponojnë motor apo ciklomotor, por që janë familje në kushte të varfërisë ekstreme, familje që kanë probleme të mëdha shëndetësore, familje që kanë fatkeqësi njerëzore etj.
7. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

**KRYETAR KËSHILLI**

**Hysen KOLDASHI**

